

# Mbetjet e Ngurta Urbane, 2024

**Tiranë, më 23 Shtator 2025:** Në vitin 2024, në Shqipëri janë menaxhuar gjithsej 862.241 tonë mbetje, me një rritje prej 2,14 % krahasuar me vitin 2023. Çdo banor gjeneroi mesatarisht 360 kg mbetje në vit. Mbetjet për banor janë rritur me 9 kg gjatë 2 viteve të fundit (nga 351 kg në 2023 në 360 kg në 2024).

Riciklimi i mbetjeve ka mbetur pothuajse i pandryshuar, ndërsa depozitimi në landfille vazhdon të dominojë si metoda kryesore. Përbërja e mbetjeve urbane ka ruajtur të njëjtën strukturë ndër vite, me rritje të lehtë të plastikës dhe metaleve.

## Kryesore

- 89,5 % e mbetjeve janë mbetje familjare dhe të ngjashme me to (771 mijë tonë).
- Mbetjet organike përbëjnë më shumë se gjysmën e totalit (57,3 %).
- Plastika dhe letra/kartoni janë kategoritë pasuese (rreth 9–10 % secila).
- 76,3 % e mbetjeve u depozituan në landfille.
- 18,8 % e mbetjeve u ricikluan.
- 4,9 % u dogjën për energji.
- Hedhjet jashtë landfillit janë reduktuar ndjeshëm, duke mbetur vetëm në 0,02 % të totalit.

**Tab. 1 Mbetje urbane të menaxhuara gjithsej dhe për banor rezident 2022-2024**

Viti	Gjithsej Mbetje	Menaxhuar Gjithsej	Mbetje jo urbane	Mbetje Urbane
	Tonë	kg/banor/vit	kg/banor/vit	kg/banor/vit
2022	820.322	295	34	261
2023	844.157	351	36	315
2024	862.241	360	38	322

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

\*Të dhënat për mbetjet e menaxhuara për kg/ban janë llogaritur duke u bazuar në popullsinë e 1 Janar 2024.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Mbetjet e Ngurta Urbane, 2024](#)

**Për publikim 23/09/2025**

# Metodologjia

Që nga viti 2020, mbledhja e të dhënave bëhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet pyetësorëve online të dërguar në të gjitha bashkitë e vendit. Ky proces përmirëson cilësinë, saktësinë dhe transparencën e statistikave vjetore mbi mbetjet urbane.

Informacioni mbi mbetjet e ngurta urbane në Shqipëri është vjetor dhe i përgjithësuar në shkallë vendi. Të dhënat e paraqitura në këtë publikim janë mbledhur në terren nëpërmjet intervistimit online me pyetësor elektronik të personelit që merret me menaxhimin e mbetjeve në bashkitë përkatëse.

Mbetjet e ngurta urbane, objekt i këtij publikimi, janë mbetjet e ngurta familjare dhe mbetjet e tjera të ngjashme me to, të cilat vijnë nga shërbimet komunitare ndaj popullatës në zonat e banuara, qoftë dhe përkohësisht. Statistikat e mbetjeve urbane u referohen treguesve statistikorë standard, sipas përcaktimeve në legjislacionin Shqiptar dhe atë evropian, duke implementuar të njëjtat klasifikime dhe përkufizime sipas rregulloreve përkatëse, *Programin e Statistikave Zyrtare të Shqipërisë në periudhën 2022 – 2026, Rregullorja e Komisionit Evropian Nr 2150/2002 mbi "Statistikat e mbetjeve"*.

## Përkufizime

**Mbetje të Ngurta Urbane;** Çdo substancë ose objekt i ngurtë, që zotëruesi i tyre dëshiron ose është i detyruar ta hedhë. Kjo përfshin mbetjet familjare dhe të tjera të ngjashme, që gjenerohen në zona të banuara si pjesë e shërbimeve komunitare.

**Mbetje të menaxhuara me fonde publike:** Mbetje të cilat menaxhohen nga pushteti vendor dhe financohen nga buxheti i bashkive për banorët rezidentë në territorin administrativ të tyre.

**Mbetje urbane:** Pjesa e mbetjeve të ngurta që rrjedh nga familjet dhe shërbimet e përditshme komunitare (jo-industriale). Ato zakonisht mbledhen në kazanet e qytetit dhe përbëjnë shumicën e mbetjeve të menaxhuara.

**Mbetje jo-urbane:** Mbetje që nuk burojnë drejtpërdrejt nga familjet apo shërbimet komunitare, por që ndonjëherë menaxhohen së bashku me mbetjet urbane. Përfshijnë mbetje industriale, ndërtimi etj.

**Mbetje industriale të menaxhuara bashkë me ato urbane:** Mbetje që vijnë nga veprimtaria industriale (veçanërisht nga biznese të vogla në zona urbane), të cilat depozitohen në të njëjtët kazanë dhe menaxhohen së bashku me mbetjet urbane.

**Përbërja relative e mbetjeve:** Tregon përqindjen në peshë të çdo kategorie materiali (si organike, plastike, letër etj.) përkundrejt totalit të mbetjeve të menaxhuara.

**Trajtimi i mbetjeve:** Përfshin mënyrat standarde të trajtimit të mbetjeve, si:

- Depozitimi në landfille – hedhja në vende të autorizuara për mbetje.
- Djegia për energji – incinerimi për përfitim energjie.
- Djegia për eliminim – incinerimi pa përfitim energjie.
- Riciklimi – rikuperimi i materialeve për përdorim të mëtejshëm.
- Hedhje jashtë landfillit – mbetje të pakontrolluara ose jashtë sistemit të menaxhimit formal.

**Kilogram për banor në vit:** Njësi matëse që tregon sasinë mesatare të mbetjeve të gjeneruara nga çdo banor gjatë një viti.